

PREFEKTURA DIBËR
Ardhur
Nr. 569 dt. 03.07.25



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

2448

Nr. _____ Prot

03 07

Peshkopi, më _____.2025

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr. 24


Datë: 02.07.2025 .

“PËR NJË NDRYSHIM NË BUXHETIN E BASHKISË PËR VITIN 2025

“Për shpërblim të ekipit të volejbollit për arritje në Superligë”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak



Kupja
03-07-2025
[Signature]



2448/09/07/25

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.569/1 prot.

Peshkopi, më 09.07.2025

Lënda: Për vendimin nr.24, datë 02.07.2025 të Këshillit të Bashkisë Dibër.

BASHKISË DIBËR

DIBËR

Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, datë 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", i ndryshuar, neni 16, pas verifikimit për efekt ligjshmërie të vendimit të Këshillit të Bashkisë Dibër nr.24, datë 02.07.2025 "**Për një ndryshim në buxhetin e bashkisë Dibër për vitin 2025 "Për shpërblim të ekipit të volejbollit për arritje në Superligë"**", vendosa:

Miratimin në parim të vendimit objekt verifikimi dhe shqyrtimi në kushtet e zbatimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën përkatëse, nën përgjegjësinë direkte administrativo-ligjore të strukturave të posaçme të Bashkisë Dibër që paraqesin për miratim projekt akte të kësaj natyre.

PREFEKTI

Nexhbedin SHIBHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 24 Datë 02/07/2025

PËR NJË NDRYSHIM NË BUXHETIN E BASHKISË PËR VITIN 2025

“Për shpërblim të ekipit të volejbollit për arritje në Superligë”

Në mbështetje të:

- - Ligji nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 34, 40, 41, 54, 55,
- Ligji nr. 9936 dt. 26/06/2008 “Për Menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar,
- Ligji nr. 10 296 dt. 08.07.2010, “Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin „
- Ligji nr. 68/2017 dt. 27/04/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore”
- Udhëzimin Plotesues Nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore ”
- Udhëzimin Nr. 8 datë 28.02.2025 “Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028 ”
- Udhëzimin Nr. 7 datë 28.02. 2022 , per nje ndryshim ne udhezimin nr.23 dt 23.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore ”
- Udhëzimin Plotesues Nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit te buxhetit ”, i ndryshuar me Udhëzimin nr.31, date 18.11.2022.
- Udhëzimin Plotesues Nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore ”.
- Udhëzimin Plotesues Nr. 21 datë 07.07.2023 “Për procedurat standarte të zbatimit te buxhetit ”,
- Udhëzimin Plotesues Nr. 2 datë 24.01.2025 “Për zbatimin e buxhetit te vitit 2025”
- Shkresen Nr. 17 date 02.07.2025 “Kerkese per shperblim te ekipit te volejbollit per arritje ne superlige”protokolluar nga Bashkia Diber me numer 2433 dhe date protokolli 02.07.2025,

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **02.07.2025**, me 20 vota pro, 0 kundër dhe 2 apstenim:

VENDOSI:

1. Të pakësohet fondi rezervë:

Gr. 0.0 Tit. 1110 Kap. 1 Art 609 650,000 lekë

Shperblim per volejbollistet 13*50,000

Gr. 0.0 Tit. 1110 Kap. 1 Art 609 250,000 lekë

Shperblim per trajneret 2*100,000


Të shtohet artikulli 606 Shumesporti :

Gr. 0.0 Tit. 8130 Kap. 1 Art 606 900.000 lekë

Shuma totale: 900,000 (Nenteqind mije) lekë.

2. Me zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Ekonomike (Sektori i Financës) pranë Bashkisë Dibër.
3. Ky vendim hyn në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit Bashkiak Dibër dhe shprehjes për bazueshmëri ligjore nga institucioni i Prefektit të Qarkut Dibër
4. Vendimi u shpall me datë **02.07.2025**.

Zv/Kryetar i Këshillit Bashkiak



BASHKIA DIBËR
DREJTORIA EKONOMIKE
Sektori i Financës

PËR PERDORIM TE FONDIT REZERVE NE BUXHETIN E BASHKISE
PËR VITIN 2025

"Per shperblim te ekipit te volejbollit per arritje ne Superlige"

Në mbështetje të:

- Ligji nr. 139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore" neni 34, 40, 41, 54, 55,
- Ligji nr. 9936 dt. 26/06/2008 "Për Menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH", i ndryshuar,
- Ligji nr. 10 296 dt. 08.07.2010, "Për Menaxhimin financiar dhe kontrollin",
- Ligji nr. 68/2017 dt. 27/04/2017 "Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore"
- Udhëzimin Plotesues Nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore "
- Udhëzimin Nr. 8 datë 28.02.2025 "Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2026-2028 "
- Udhëzimin Nr. 7 datë 28.02. 2022 , per nje ndryshim ne udhezimin nr.23 dt 23.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore "
- Udhëzimin Plotesues Nr. 9 datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit te buxhetit ", i ndryshuar me Udhëzimin nr.31, date 18.11.2022.
- Udhëzimin Plotesues Nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore " .
- Udhëzimin Plotesues Nr. 21 datë 07.07.2023 "Për procedurat standarte të zbatimit te buxhetit ",
- Udhëzimin Plotesues Nr. 2 datë 24.01.2025 "Për zbatimin e buxhetit te vitit 2025",
 - Shkresen Nr17 date 02.07.2025 "Kerkese per shperblim te ekipit te volejbollit per arritje ne superlige" prokolluar nga Bashkia Diber me numer2433 dhe date protokolli 02.07.2025

Të pakësohet fondi rezervë:

Gr. 0.0 Tit. 1110 Kap. 1 Art 609 650,000 lekë

Shperblim per volejbollistet 13*50,000

Gr. 0.0 Tit. 1110 Kap. 1 Art 609 250,000 lekë

Shperblim per trajneret 2*100,000

Të shtohet artikulli 604 Shumesporti :

Gr. 0.0 Tit. 8130 Kap. 1 Art 606 900.000 lekë

Shuma totale: 900,000 (Nenteqind mije) lekë.

PËR BASHKINË DIBËR:

Drejtör Juridik
Ismet SARAGI



Sekretar Klubi Shumesportesh


Drejtör Ekonomik
Çeljeta ZUNA



Specialiste Buxheti
Erbolina SELA



Algert Brahasani




KRYETARI

Rahim Spahiu

Në mungesë dhe me porosi

Nënkryetari bashkisë

Lorenc CIBAKU





REPUBLIKA E SHQIPERISE

KLUBI SHUMESPORTESH
DIBER

2433 02/07/25
Peshkopi, më 02/07/2025

Nr./Prot

Drejtuar: Kryetarit Bashkise Diber ,Keshillit Bashkiak

Lënda: Kërkesë për shpërblim të ekipit të volejbollit për arritjen në Superligë

Në emër të stafit drejtues dhe të gjithë anëtarëve të ekipit të volejbollit Korabi ju drejtohem me këtë kërkesë për të kërkuar një shpërblim simbolik dhe motivues për skuadrën tonë, e cila ka arritur një sukses të rëndësishëm duke siguruar ngjitjen në Superligën Kombëtare të Volejbollit në sezonin 2024-2025.


Ky sukses është rezultat i një pune të palodhur, përkushtimi të vazhdueshëm të sportistëve tanë dhe mbështetjes së stafit teknik e drejtues. Përveç rëndësisë sportive, ky arritje ka një ndikim të drejtpërdrejtë në promovimin e emrit të qytetit tonë dhe në nxitjen e të rinjve drejt sportit, disiplinës dhe bashkëpunimit.

Duke marrë parasysh rëndësinë e këtij sukcesi dhe ndikimin pozitiv që ka për komunitetin lokal, ju kërkojmë të shqyrtoni mundësinë e akordimit të një shpërblimi financiar për ekipin, si një mënyrë vlerësimi dhe inkurajimi për të ardhmen.

Duke ju falënderuar dhe shpresojme për mbështetjen tuaj.

SEKRETARI KLUBIT SHUMSPORTESH

Aligert BRAHASNI



RELACION

Për: Shpërblimin e Klubit të Volejbollit "Korabi" për arritjet gjatë sezonit 2024-2025

Me anë të këtij relacioni, ju bëjmë me dije se ekipi i volejbollit **Korabi**, pas një sezoni të suksesshëm ka arritur të sigurojë ngjitjen në **Superligën Kombëtare të Volejbollit** për sezonin 2024-2025.

Në përputhje me sukseset e arritura nga Klubi i Volejbollit "Korabi" gjatë këtij sezoni si dhe rregulloreve për shpërblimin e sportistëve dhe klubeve sportive që përfaqësojnë denjësisht komunitetin tonë në gara kombëtare, paraqesim këtë relacion për vlerësimin dhe shpërblimin e merituar të këtij klubi.

Duke marrë parasysh rezultatet e larta të arritura, angazhimin profesional të trajnerëve dhe sportistëve, ndikimin pozitiv në komunitet si dhe kërkesën drejtuar kryetarit të Bashkisë Dibër dhe Këshillit Bashkiak me nr.17 datë 02.07.2025 protokolluar në Bashkinë Dibër me nr. 2433 datë 02.07.2025, ky grup të shpërblehet në përputhje me rregulloren për shpërblimet sportive, si një nxitje për të vijuar performancën e lartë dhe për të motivuar brezat e rinj drejt sportit.

Forma e shpërblimit do të jetë financiar që do të mundësohet nga Fondi Rezervë për vitin 2025.

Drejtor Ekonomik

Çeljeta ZUNA

